



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.387/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Milena Gjeriq dhe Beshir Islami anëtarë, në çështjen juridike të paditëses J. K. nga fshati ..., Komuna e D., të cilën e përfaqëson me autorizim Avokatura MBN, shpk., me avokat Blerim Syla nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ D. “, me seli në P., të cilën e përfaqëson me autorizim avokati Nexhmidin Demolli nga P., për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.8526/2022 datë 1.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.09.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pa themeltë revizioni i paditëses J. K. nga fshati ..., Komuna e D., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.8526/2022 dt.1.03.2024.

### A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1390/2019 dt.23.03.2022, është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditëses. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, detyrohet e paditura, që paditëses t’ia paguajë shumën si në vijim: Dëmin jo material për paditësen, në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2200-euro, në emër të frikës shumën prej 2200-euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 4,500-euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 1,600-euro, në shumë të përgjithshme prej

10,500-euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit ( 23.03.2022) deri në pagesën e plotë të shumës, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim përmbarimi me dhunë. Dëmin material, në emër të ndihmës së huaj, shumën prej 300-euro, ushqim të përforcuar 300-euro, shpenzime të mjekimit 1360,01 –euro, në emër të terapisë, shumën prej 132,06-euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë. Me pjesën e III të dispozitivit, detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 2.107.00-euro, dhe me pjesën e IV të dispozitivit, defuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar për dëmin material dhe jo material sikurse nën p.II të aktgjykimit.

Me pjesën e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.8526/2022 datë 1.03.2024, aprovohet pjesërisht si e themeltë ankesa e paditëses, ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, në pikën II të dispozitivit të tij, dhe gjykohet si vijon: Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditëses si e bazuar, detyrohet e paditura t’i paguajë paditëses në emër të dëmit jo material, për dhimbjet fizike shumën prej 3900-euro dhe për frikën shumën prej 3500-euro, me kamatë vjetore prej 8% e cila llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ( 23.03.2022 ) e deri në pagesën definitive. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, refuzohet si e pa themeltë ankesa e të paditurës dhe pjesërisht ankesa e paditëses, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, i sipër përmendur, në pjesët tjera të tij, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqitur revizion paditësja për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, sa i përket lartësisë së kompensimit dhe llogaritjes së kamatës, me propozim që të aprovohet revizioni, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet, dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses e precizuar sipas parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë së dt.7.03.2022, si e bazuar.

Përgjigje në revizion ka paraqitur pala e paditur, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, si dhe vlerësimit të pretendimeve të revizionit gjeti se:

Revizioni i paditëses është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja më datën 6.09.2019, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të pësuar në aksidentin e komunikacionit të dt.15.05.2019, me të dhënat tjera si në padi dhe petitumin e saj, përkatësisht si në precizimin e saj. Nga leximi i raportit të policisë nr.2018 – ..., dt.15.05.2019, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se më dt.15.05.2019, rreth orës 19, në rrugën Dragash – Zhur, tek kthesa e Rapqes, është shkaktuar fatkeqësia e komunikacionit, me ç'rast lëndime trupore ka pësuar tani paditësja J. K. Nga leximi i kërkesës për avancë, të dt.6.08.2019, të parashtruar nga paditësja, vërtetohet se e njëjta ka kërkuar avancë nga e paditura në emër të lëndimeve të pësuar nga aksidenti. Nga leximi i raporteve mjekësore, del se paditësja i është nënshtruar disa kontrolleve mjekësore, fillimisht në QKMF në Dragash, pastaj në Spitalin Rajonal në Prizren, si dhe ndërhyrje kirurgjike në QKUK në P.. Nga shikimi i faturave të shpenzimeve të terapisë etj , vërtetohen shpenzimet që janë bërë çka dëshmohet me kuponat fiskal, që gjenden në shkresat e lëndës. Nga deklarata e ekspertit të ortopedisë në shqyrtimin kryesor dt.24.02.2022, punuar nga Dr.V. B. ortoped – traumatolog, vërtetohet se paditësja si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka pësuar lëndime të rënda trupore në frakturë shumë fragmentesh të pjesës së poshtme të humeruesit të djathtë, lezion i nervit radikal dhe përdredhje e qafës, nga të cilat lëndime ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë për 20 minuta, me ekzaminimet tjera, të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertes mjekësore, ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 7.5%, shëmtim trupor të shkallës së ulët., ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për 8 javë, ndihmë të personit të tretë për 8 javë, rehabilitim fizik për 2 vite, rresht prej 15 ditësh. Nga leximi i ekspertizës së psikiatrisë të Dr.B. O., dt.6.12.2021, vërtetohet se paditësja, si pasojë e aksidentit ka pasur frikë primare që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 60 minuta, etj, me të dhënat tjera, të përshkruara në mënyrë detaje në ekspertizën përkatëse.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe në bazë të nenit 136, nenit 169, nenit 179, nenit 183 , nenit 382 të LMD-së, ka vendosur si në pjesën I,II, III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, e ka miratuar pjesërisht ankesën e së paditëses, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka vendosur si në pjesën I dhe II të dispozitivit të sipër theksuar të aktgjykimit të saj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur ka miratuar pjesërisht ankesën e paditëses dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në kuptimin e mësipërm, ndaj, aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje të karakterit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare dhe as shkelje të së drejtës materiale.

Për sa i përket shumave të gjykuara nga Gjykata e shkallës së parë dhe nga gjykata e shkallës së dytë (pjesa e ndryshuar), përkritazi me llojet e sipër përmendura të dëmit jo material dhe material, drejtë është aplikuar dispozita e nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe në përputhje me nenin 323 të LPK-ës, duke pasur parasysh, në këtë rast, konstatimet dhe mendimet e ekspertëve përkatës mjekësor, të ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë, lëndimet e pësura trupore ( lëndim i rëndë trupor ) dhe pasojat, natyrën, peshën, intensitetin e dhimbjeve, frikës, shkallën e shëmtimit trupor,(shkalla ulët) shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të paditësit(7.5%).Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jo material (si një satisfacion që nuk ka qëllim lukrativ-fitimprurës), përfaqëson zbatimin e së drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, dhimbjeve fizike, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtimit, por edhe të frikës si lloj i mëvetësishëm i dëmit jo material, gjykata sipas nenit 183 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por, edhe për faktin që të mos favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror, prandaj, duke pasur parasysh këto kritere të parapara me dispozitën e lartë cekur, shumat e caktuara nga gjykatat e instancës më të ulët, përkritazi me llojet e sipër cekura të dëmit jo material, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale, në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore. Gjykata e instancës më të ulët, me rastin e vendosjes për llojet dhe shumat e kompensimit të dëmit jo material dhe material të paditësit, ka pasur parasysh konstatimet që u sipër theksuan më lartë, e veçanërisht, përkritazi me paditësin, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor të tij (7.5%), shkallën e shëmtimit trupor (shkalla ulët), me manifestim të sipër përshkruar të pasojave të konstatuara nga ekspertizat mjekësore.

Prandaj, nga këtu, thëniet e revizionit të paditëses përkritazi me shkeljet e pretenduara të dispozitave ligjore, lidhur me lartësinë e shumave të gjykuara, kjo Gjykatë i vlerësojë si të pa themelta. Gjithashtu e vlerësojë si të pa bazuar edhe pretendimin e revizionit që ka të bëjë me kamatën, përkritazi me të, gjykatat kanë aplikuar drejtë dispozitat përkatëse të LMD-së( neni 382),

dhe kanë vendosur në përputhje me pikën XIV dhe XV të Mendimit Juridik të GJSK të dt.2.12.2020, po ashtu, nuk qëndron as pretendimi i revizionit përkitazi me kërkesën që kamata të llogaritet në lartësinë prej 12%, për faktin sepse e paditura, sikundër rezulton nga Njoftimi SMS i dt.19.08.2019, ( që gjendet në shkresat e lëndës ) i është përgjigjur paditëses lidhur me kërkesën e saj për avancë, ndaj, ka vepruar më përputhje me dispozitat e nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Nga sa u theksua më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.387/2024 datë 24. 09. 2024

Kryetari kolegjit

Mr.sc.Muhamet Rexha